

19 korrik 2017



Rrjeti i Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financa dhe Integrim Evropian në Ballkanin Perëndimor (RrKP)

Akti për organizim dhe struktura drejtuese

I. Organizimi

Rrjeti i Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financa dhe Integrim Evropian të Ballkanit Perëndimor (RrKP) është themeluar në mënyrë joformale në vitin 2009, dhe funksioni i tij është përcaktuar në deklaratën e miratuar në konferencën e vitit 2009. Bazuar në deklaratën e miratuar në vitin 2009, më 2 qershor 2013, në konferencën rajonale në Beçiq, në Mal të Zi, anëtarët ekzistues të rrjetit vendosën që anëtarësimi në Rrjet formalisht të zgjerohet, duke u ofruar munësia për anëtarësim komisioneve për integrimin evropian nga parlamentet e rajonit të Ballkanit perëndimor, duke e riemëruar dhe transformuar në këtë mënyrë rrjetin ekzistues në **Rrjet të Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financa dhe Integrim Evropian të Ballkanit Perëndimor (RrKP)**.

Përveç zgjerimit të pjesëmarrjes, është marrë edhe vendim për themelimin e Këshillit të Rrjetit dhe zhvillimin e mëtejshëm të strukturës organizative dhe administrative.

Rrjeti nuk ka subjektivitet juridik ndërkombëtar, nuk është një organizatë ndërkombëtare dhe çdo pjesëmarrës në Rrjet flet për vetveten. Pjesëmarrja e komisioneve dhe deputetëve në rrjet është në baza vullnetare dhe gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me praktikat e përcaktuara për pjesëmarrje në iniciativat rajonale.

II. Kuvendet pjesëmarrëse

Pjesëmarrësit në Rrjet janë zyrtarë të zgjedhur që kryejnë funksione në komisionet parlamentare për Ekonomi, Financa dhe Integrim Evropian në 8 parlamentet e Ballkanit perëndimor nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina¹, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova*. Pjesëmarrësit në rrjet janë:

¹ Në përputhje me Kushtetutën e BH, Bosnja dhe Hercegovina ka 3 parlamente në Rrjet: Kuvendi parlamentarë i Bosnjës dhe Hercegovinës; Parlamenti i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kuvendi kombëtarë i Republikës Srpska.

*Emërimi i tillë nuk e vë në pikëpyetje statusin dhe është në përputhje me Konventën 1244 dhe mendimit këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Kuvendi i Shqipërisë

- Komisioni për Ekonomi dhe Financa
- Komisioni për Integrim Evropian

Kuvendi Parlamentar i Bosnjës dhe Hercegovinës

- Komisioni për Financa dhe Buxhet (Dhoma e Popujve dhe e Përfaqësuesve)
- Komisioni për Reforma Ekonomike dhe Zhvillim
- Komisioni i përbashkët për Integrim Evropian

Kuvendi Parlamentar i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës

- Komisioni për Ekonomi dhe Politika Financiare
- Komisioni për Ekonomi dhe Politika Zhvillimore, Financa dhe Buxhet
- Komisioni për Integrim Evropian të Dhomës së Popujve
- Komisioni për Integrim Evropian

Kuvendi Kombëtar i Republika Srpska

- Komisioni për Financa dhe Buxhet
- Komisioni për Integrim Evropian dhe Bashkëpunim Rajonal
- Komisioni për Çështje Ekonomike

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

- Komisioni për Financim dhe Buxhet
- Komisioni për Çështje Ekonomike
- Komisioni për Integrim Evropian

Kuvendi i Malit të Zi

- Komisioni për Ekonomi, Financa dhe Buxhet
- Komisioni për Integrim Evropian

Kuvendi Kombëtar i Serbisë

- Komisioni për Financa, Buxhet Shtetëror dhe Kontrollë të Shpenzimeve të Mjeteve Publike
- Komisioni për Ekonomi, Zhvillim Rajonal, Tregti, Turizëm dhe Energjetikë
- Komisioni për Integrim Evropian

Kuvendi i Republikës së Kosovës

- Komisioni për Buxhet dhe Financa
- Komisioni Mbikëqyrës për Financa Publike
- Komisioni për Integrim Evropian
- Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Për pranim të pjesëmarrësve të ri në Rrjet nevojitet pëlqimi i të gjithë pjesëmarrësve ekzistues ne Rrjet.

III. Këshilli i Rrjetit

Këshilli i RrKP-së është i përbërë nga kryetarët/ zëvendësit ose anëtarët/ deputetët e komisioneve për Ekonomi, Financa dhe Integrim Evropian të kuvendeve pjesëmarrëse.

Anëtarët e Këshillit emërohen për mandat 2 vjeçar. Mandati aktual i këshillit zgjat nga 19 korrik 2017 deri në 18 korrik 2019. Pjesëmarrja është në baza vullnetare.

Nëse mbahen zgjedhje në një nga kuvendet pjesëmarrëse gjatë mandatit aktual të RrKP, pas themelimit të kuvendit të ri, anëtarët e këshillit të RrKP do të ri-emërohen nga komisionet përkatëse, deri në fund të këtij mandati.

Këshilli i RrKP përbëhet prej:

- 1 deputet nga secili kuvend që merr pjesë në Rrjet dhe 1 zëvendës deputet nga çdo kuvend që merr pjesë në punën e Rrjetit. Gjatë formimit të Këshillit të rrjetit, RrKP-ja do të merr parasysh masa që të sigurohet se ka ekuilibër mes anëtarëve qeverisës dhe opozitar të kuvendeve pjesëmarrëse në Rrjet.
- Këshilli i Rrjetit drejtohet nga kryetarë rotacional i cili drejton punën e këshillit.
- Kryetari rotacional zgjidhet në takim të këshillit të rrjetit me mandat 6 mujor dhe kryen funksionin deri në zgjedhjen e kryetarit të ardhshëm.
- Kuvendi prej të cilit vjen kryetari i këshillit dhe komisioni relevant ku kryetari kryen funksionin e vet kanë rolin e kontaktit joformal të Rrjetit gjatë periudhës së mandatit të atij kryetari rotacional.
- Nëse dikush nga anëtarët e përhershëm të këshillit nuk mund të merr pjesë në takim të këshillit, në atë rast ai/ajo do duhet të emëron zëvendës-anëtar të këshillit që do të merr pjesë dhe do të merr vendime gjatë takimeve të këshillit.

IV. Përgjegjësitë e Këshillit të RrKP

- Këshilli i RrKP drejton punën e Rrjetit.
- Përpilon dhe miraton planin vjetor të punës dhe veprimit në të cilin përcaktohet shtrirja dhe korniza kohore e aktiviteteve të Rrjetit.
- Formon grupe të punës, përgjegjëse për shqyrtimin e nismave të posaçme të rrjetit.
- Dorëzon raporte tek pjesëmarrësit e Rrjetit.
- Merr vendime për dhe drejton bashkëpunimin e Rrjetit me organizatat ndërkombëtare, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, donatorët, parlamentet e Ballkanit perëndimor dhe nismat tjera të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare.
- Formon sekretariatit e Rrjetit.
- Miraton Rregulloren e Punës së këshillit të RrKP.

- Përgatit konferencën vjetore të Rrjetit.
- Merr vendime për aktivitete tjera që do të përparojnë zhvillimin e bashkëpunimeve rajonale dhe ndërkombëtare të Rrjetit.

V. Formati i takimeve të Këshillit

Këshilli i Rrjetit do të synon të mban takime të rregullta tremujore për drejtim:

- Në takimin tremujor për drejtim të këshillit të Rrjetit bëhet koordinimi dhe drejtohet puna e Rrjetit.
- Takimet tremujore të këshillit të Rrjetit janë të hapura për pjesëmarrësit e kuvendeve tjera, organizatave ndërkombëtare, OJQ dhe partnerëve si mysafir pas pranimit të ftesës nga ana e këshillit të Rrjetit, nëse këshilli konsideron se pjesëmarrja e tyre është e rëndësishme për zhvillimin e punës së Rrjetit.
- Këshilli i Rrjetit siguron drejtime veprimi dhe mbikëqyrje të organizatës ndërmjet takimeve vjetore të Rrjetit.
- Këshilli miraton Strategjinë dhe programin e punës të Rrjetit, ndjek zhvillimin gjatë vitit dhe jep propozime dhe nisma për zhvillim të mëtutjeshëm të bashkëpunimit rajonal.
- Takimet e këshillit thirren nga kryetari i këshillit, kurse përgatiten nga sekretariati i Rrjetit.

VI. Konferenca vjetore e RrKP

Njëherë në vit, RrKP mban takim me përfaqësuesit e të gjitha komisioneve që marrin pjesë në punën e Rrjetit që të kryen shqyrtim në punën e vitit të kaluar dhe që ti ofrohen propozime dhe drejtime të këshillit për aktivitetet e ardhshme të Rrjetit.

Pjesëmarrës të konferencës vjetore të Rrjetit janë kryetarët dhe zëvendësit-kryetarëte Komisioneve për Ekonomi, Financa dhe Integritet Evropian dhe anëtarëve të këshillit.